



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 494/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Kosova Demokratik Turk Partis (KDTP), dega në Mamushë, paraqitur kundër subjektit politik të Kosova Turk Adalet Partis (KTAP), dega në Mamushë, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partis (KDTP), dega në Mamushë.

#### Arsyetim

Me datën 04.11.2013, subjekti politik KDTP, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon, se në QV me nr. N0:01 në Komunën e Mamushës është sulmuar fizikisht kryesusi i V.V për shkak se nuk ka lejuar votimin disa herë nga personat e njëjtë. Lidhur me këtë rast është njoftuar KDI, Enemo dhe Policia e Kosovës.

Parashtruesi i ankesës ka dhënë disa emra si dëshmitar të cilët ishin vëzhgues në këtë QV Hamit Taq, Gani Mazreku si dhe kryesuesi Isak Kryezi po ashtu nga radhët e KDTP-së.

Në përgjigjen e datës 05.11.2013 të ofruar në PZAP nga Policia e Kosovës theksohet se për rastin në fjalë Policia e Kosovës me datën 04.11.2013 ka iniciuar rastin me nr. 2013-GM-23 në të cilën theksohet se rasti në fjalë ka të bëjë me lëndim i lehtë trupor dhe se për këtë rast janë intervistuar tre persona të përfshirë në ngjarjen e sulmit fizik si në ditën e zgjedhjeve po ashtu edhe ditën e nesërme.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

#### **Ankesa është e pabazuar.**

Me nenin 118.4 LZP-sw, parashihet se: *“Mund te apelothen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.*

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë pasi që nuk ka prova të mjaftueshme për tu vërtetuar se këta persona janë anëtarë apo simpatizantë të ndonjë

subjekti të caktuar politik, kjo vërtetohet edhe përmes raportit të policisë me nr. 2013-GM-23 të datës 05.11.2013, ndërsa rreth asaj se të dëmtuarit i është shkaktuar lëndim trupor është bërë kallzim penal ndaj Mitat Taq dhe Hajrullah Taq dhe rasti në fjalë është hapur pranë prokurorisë kompetente dhe çështja është në procedure te rregullt gjyqësore, prandaj PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 494/2013 më datën 07.11.2013



**Kryesuesi i panelit  
Hasan Shala**

***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*